

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Tri tipare dalluese shënon raporti vjetor i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të cilat do të doja t'i sillnim sot para jush, pasi është jashtëzakonisht e rëndësishme që në ngrehinën e një shteti modern dhe të një ekonomie të tregut të lirë të vërejmë mirë ecurinë e institucioneve të pavarura e të rregullatorëve të pavarur. Tipari i parë dallues, që raporti e tregon qartë, është vigjilenca që ka treguar Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të parandaluar dështimet e tregjeve, për shkak të goditjeve të jashtme, por edhe monitorimi i vazhdueshëm që ka bërë ky Autoritet për zhvillimet në tregun financiar jobankar.

Kam parasysh këtu gjithë rezistencën e nevojshme pas tri goditjeve unikale të jashtme që kanë pasur tregjet. Një prej goditjeve ka qenë tërmeti. Të mos harrojmë që të gjitha kompanitë e sigurimeve kanë luajtur rol aktiv në mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti. E tregon qartë edhe raporti, që kemi pasur për shpërblim për të gjitha dëmet. Është një numër shumë i vogël çështjesh që ka përfunduar në kontrollin gjyqësor dhe do ta kryejë kontrolli gjyqësor, përkundrejt malit të madh të çështjeve që ka mbuluar vetë tregu. Goditja e dytë është pandemia, efektet e së cilës kanë qenë vazhduese. Vigjilenca e Autoritetit tregohet qartë në mirëkapitalizimin e të gjitha tregjeve, si ai i sigurimeve, i fondeve të investimit apo i fondeve të pensioneve.

Niveli i provigjoneve, po marr si shembull jojetën, është 131% , ndërkohë që sigurimi i jetës është 125%, megjithëse përqindja është e vogël në volumin e madh. Dua të them që vigjilenca e AMF-së mbi efektet që mund të sillnin krizat, ka qenë e tillë që nuk ka lejuar në asnjë moment që krizat, qoftë tërmeti, qoftë pandemia, qoftë kriza e çmimeve për shkak të luftës në Ukrainë

të shndërroheshin në kriza të sistemit tonë financiar. Sistemi ynë financiar jobankar është likuid, është i sigurt dhe vazhdon udhëtimin e vet drejt integritit me tregjet globale. Tipari i dytë dallues është se Autoriteti ka qenë i papërtuar.

Pra, raporti tregon se veprimtaria e Autoritetit gjatë vitit 2021 ka qenë e papërtuar për të nxitur stabilitetin makroekonomik. Të shohim vetëm numrin e akteve ligjore dhe akteve nënligjore, të cilat sigurojnë, vendosin mekanizma mbrojtës në stabilitetin makroekonomik të vendit; është mbresëlënëse! Janë tri ligje të miratuara gjatë vitit 2021, ndërkohë që janë gati 20 rregullore dhe akte të tjera nënligjore. Si ish-punonjës në sistemin bankar dhe financiar, të kalosh një numër të tillë ligjesh dhe aktesh nënligjore me të vërtetë tregon shpejtësinë admiruese me të cilën Autoriteti ka reaguar për të vendosur tulla të tjera në themelin e stabilitetin makroekonomik. Tipari i tretë dallues i Autoritetit është inovacioni për të mbrojtur investitorët, konsumatorët, si dhe transparencën e tregut.

Po të lexosh raportin, del qartë se, qoftë nëpërmjet zbatimit të risive teknologjike, por edhe zbatimit të risive rregullative, konsumatori, investitori është më i mbrojtur sot sesa dje. Janë pikërisht këto tri tipare dalluese, që nga raporti del qartë se kanë siguruar tashmë një kredo besimi ndaj këtij Autoriteti. Ndaj e gjej me vend për t'i rreshtuar ato. Së pari, besimi i investitorëve në tregjet financiare. E tregon vetë numri i investitorëve. Qoftë investitorët në tregun e investimeve, qoftë investitorët në tregun e pensioneve, qoftë investitorët në tregun e sigurimeve janë rritur. Janë përqindje rritjeje të qenësishme. Pra, totali i shoqërive të sipërmarrjeve të investimeve kolektive është rritur 21,5%, ndërkohë që numri i anëtarëve në fondet e investimit është rritur 22,6%; numri i pjesëmarrjeve në fondet e pensioneve është rritur 8,2%.

Pra, kjo tregon se investitorët dhe konsumatorët po rritin investimet e tyre dhe po vazhdojnë të investojnë. Është rritur besimi i tregjeve përkundrejt Autoritetit. Këtë e tregon numri i asetëve, që ka kaluar në mbikëqyrjen e Autoritetit, por, gjithashtu, dhe shpejtësia me të cilën tregu është mirëkapitalizuar. Tregu i ka zbatuar të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullative që ka vendosur Autoriteti. Së fundi, është rritur besimi i partnerëve ndërkombëtarë. Janë dy shenja të dallueshme, si raportprogresi i Shqipërisë në integrimin europian, që i lë një vend të veçantë

punës, veprimtarisë së Autoritetit, por, gjithashtu, dhe anëtarësia që ka fituar Autoriteti pas një due diligence në shoqërinë ndërkombëtare të siguruesve, e cila na jep dhe një mundësi tjetër, që të vazhdojmë dhe të thellojmë modernizimin e tregut financiar jobankar në Shqipëri.

Pasi fola për tri tiparet dalluese të punës së veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, pasi fola për tri bashkësi, të cilat kanë vendosur tashmë besimin mbi Autoritetin, do të doja të thosha tri fjalë për Ballkanin e Hapur. Për shkak se është një mundësi e shkëlqyer ekonomike e lëvizjes së lirë të kapitalit, Autoriteti mbikëqyrës ka shtruar një themel të mirë, që mund të vazhdojë, që lëvizja e lirë e kapitalit në rajonin e Ballkanit të konkretizohet me nisma konkrete ndërmjet autoriteteve rregullative përkatëse. Faleminderit!